



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES
SEKTORI I MENAXHIMIT TË E-KËRKESAVE DHE E-ANKESAVE

Nr. 18017 prot.

Vlorë, më 04.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

DATË 31.08.2026 ORA 17:30

Tema: Konsultim Publik për Riorganizimin Administrativo-Territorial.

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkollari, Kryetarët e Rajonove, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.

Takimin e hapi Nënkryetare e Bashkisë Vlorë- znj. Irena Toshkallari: Përshëndetje! Me lejen tuaj, po zhvillojmë dëgjuesën publike lidhur me riorganizimin territorial.

z. Gjergji Nika: Dëgjesa publike nuk mund të zhvillohet vetëm me praninë tuaj. Në këtë proces duhet të marrin pjesë edhe deputetët, si dhe personat përgjegjës për këtë çështje. Gjithashtu, dua të theksoj se në Këshillin Bashkiak është miratuar shkrirja e Bashkisë Selenicë, pa u zhvilluar më parë një dëgjuesë publike dhe pa u marrë mendimi i komunitetit.

znj. Irena Toshkallari: Në vijim, po ju paraqes projektligjin për riorganizimin administrativo-territorial, në përputhje me parashikimet dhe përcaktimet e këtij projektligji. Kjo dëgjuesë publike synon informimin dhe konsultimin e komunitetit mbi ndarjen e re territoriale, si dhe ndikimi i saj për Bashkinë Vlorë.



Gjatë periudhës nëntor 2025 - Qershor 2026, Komisioni zhvilloi në tërësi 23 mbledhje dhe seanca të planifikuara. Nëpërmjet projektaktit synohet arritja e objektivave të mëposhtëm:

Reduktimi i kostove fikse administrative. Rialokimi i burimeve drejt shërbimeve publike dhe investimeve. Standard më i barabartë i shërbimeve. Njësi më të mëdha me kapacitet real për ushtrimin e funksioneve. Përmirësim i shërbimeve, nga planifikimi territorial te shërbimet sociale. Cilësia e shërbimit të mos varet nga vendbanimi i qytetarit.

Krijimi i mundësive që territoret e vogla nuk mund t'i gjenerojnë të vetme.

Projektligji propozon një riorganizim të ndarjes administrativo-territoriale të vendit, duke kaluar nga 61 në 46 bashki. Modeli i ri i riorganizimit mbështetet në kritere Ekonomike, Sociale, Kulturore, Demografike, Administrative, Financiare dhe Territoriale. Propozimi konkret Qarku Vlorë Konsolidimi i Bashkisë Selenicë me Bashkinë Vlorë, duke krijuar një Njësi të vetme të Vetëqeverisjes Vendore me qendër në Vlorë. Bashkia e konsoliduar do të përfshijë 11 Njësi Administrative; 93.263 Banorë dhe Sipërfaqe rreth 1.178km.

z. Ilia Bombaj, Selenicë: Përsëritet! Ne jemi ndër të parët që po përballemi me pasojat e bashkimit të dy bashkive. Në Shqipëri duhet të ndërtojmë dhe të punojmë për të ardhmen, jo që interesat të jenë të përqendruara te një grup i kufizuar personash. Këshilli i Bashkisë Vlorë nuk mund të përcaktojë fatet e Bashkisë Selenicë. Ju nuk po u përgjigjeni nevojave të fshatrave tuaj, aq më pak mund të pretendoni se do t'u përgjigjeni nevojave të qytetarëve të Vlorës. Selenica duhet të ketë zërin, përfaqësimin dhe vendimmarrjen e saj. Bashkitë duhet të jenë në shërbim të qytetarëve dhe jo interesave të individëve të caktuar.

z. Myzafer Elezi: Sot po zhvillojmë një dëgjese publike në Bashkinë Vlorë, ndërkohë që votimi është bërë më herët në Këshillin Bashkiak. Çdo akt dhe vendimmarrje e marrë duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Nuk është e ligjshme që Këshilli Bashkiak i Vlorës të vendosë për fatet e Bashkisë Selenicë, pasi nuk mund të ushtrojë kompetenca përtej territorit dhe juridiksionit të tij. Bashkia Selenicë dhe Bashkia Orikum duhet të kenë përfaqësimin dhe vendimmarrjen e tyre, pa qenë në varësi të Bashkisë Vlorë. Për këtë

arsye, kam propozuar që Bashkia Selenicë të rikthehet si bashki më vete, në mënyrë që vendimmarrja dhe administrimi të jenë sa më pranë qytetarëve. Situata aktuale kërkon një vlerësim të plotë juridik, pasi bashkimi i Bashkisë Vlorë me Bashkinë Selenicë dhe mënyra e ushtrimit të kompetencave duhet të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjin.

znj. Irena Toshkallari: Jemi mbledhur së bashku me qytetarët e Bashkisë Vlorë për të diskutuar riorganizimin territorial. Përcaktimi i kufijve territorialë nuk mund të bëhet pa marrë në konsideratë mendimin dhe shqetësimet e qytetarëve përmes dëgjësive publike.

z. Myzafer Elezi: Jemi shprehur qartë dhe kemi paraqitur qëndrimin tonë lidhur me Bashkinë Selenicë. Kërkojmë gjithashtu rikthimin e Bashkisë Orikum si bashki më vete, në mënyrë që qytetarët të kenë përfaqësimin dhe vendimmarrjen sa më pranë tyre.

z. Arsen Belaj: Reforma territoriale është një proces me një vizion shumë të gjerë dhe në fund vendimmarrja përfundimtare i takon Parlamentit. Për Bashkinë Selenicë, qëndrimi ynë është i qartë: është e pamundur të pranojmë bashkimin e saj me Bashkinë Vlorë.

Gjithashtu, kërkoj që Bashkia Orikum të rikthehet si bashki më vete. Buxheti dhe të ardhurat e krijuara nga territori i Orikumit duhet të përdoren në funksion të banorëve të këtij territori dhe jo të kalojnë në administrimin e Bashkisë Vlorë.

Jam kundër bashkimit të Bashkisë Selenicë me Bashkinë Vlorë dhe mbështes rikthimin e Bashkisë Orikum si njësi e veçantë vendore, me administrim, buxhet dhe vendimmarrje të pavarur.

Banor i Ramicës së Vlorës: Dua të ngre shqetësimin për problemin e mungesës së ujit. Pyetja ime është: nëse do të ndodhë bashkimi, a do të zgjidhet më shpejt ky problem nga Bashkia Selenicë apo nga Bashkia Vlorë? Mendoj se bashkimi nuk është zgjidhja e duhur për banorët tanë. Nëse ky bashkim do të realizohet, jam i bindur se shumë banorë do të shprehin kundërshtimin e tyre edhe përmes bojkotimit të zgjedhjeve.

znj. Irena Toshkallari: Dua të sqaroj se nuk do të ketë mbyllje të shërbimeve.

z. Sezai Balilaj, banues në Selenicë: Jam kundër bashkimit, pasi menaxhimi i një territori të zgjeruar do të jetë shumë më i vështirë dhe shërbimet ndaj qytetarëve rrezikojnë të largohen nga komunitetet. Gjithashtu, mendoj se Orikumi dhe Novosela duhet të jenë bashki më vete, me administrim dhe vendimmarrje të pavarur.

znj. Irena Toshkallari: Nuk do të ketë mbyllje të shërbimeve. Ndarja dhe organizimi i punëve mund të jetë pak më i vështirë.

z. Kejdi Kamberaj: Si do t'ua ofrojmë shërbimet banorëve të Shkozës dhe fshatrave përreth, kur shumë prej tyre janë mbi 80 vjeç dhe e kanë të vështirë të udhëtojnë deri në Selenicë, aq më tepër deri në Bashkinë Vlorë? Bashkia Vlorë aktualisht ka vështirësi në përballimin dhe ofrimin e shërbimeve për fshatrat që administron, ndaj është e vështirë të besohet se do të mund të përballojë edhe nevojat e banorëve të Selenicës.

Banor i Bashkisë Selenicë: Bashkia Selenicë nuk duhet të ndahet. Jemi për më shumë bashki, në mënyrë që administrimi dhe shërbimet të jenë sa më pranë qytetarëve.

z. Sulo Peshtani, banor i Njesisë Novoselë: Reforma territoriale ka dështuar. Duke qenë se territori është shumë i madh, ofrimi i shërbimeve ka qenë pothuajse inekzistent gjatë 12 viteve

të fundit. Për çdo problematikë që kemi hasur, na është thënë t'i drejtohem Bashkisë Vlorë. Taksat e banorëve të Novoselës investohen në qytetin e Vlorës, ndërkohë që Novosela ka resurse të shumta dhe nevoja të mëdha për investime dhe zhvillim. Problematikat në zgjidhjen e çështjeve të komunitetit, mungesa e shërbimeve dhe investimeve kanë ndikuar edhe në rritjen e shpopullimit të zonës. Si banor i Novoselës, kërkoj që Novosela të rikthehet në një bashki më vete, duke pasur një pushtet vendor pranë qytetarëve, ashtu siç e ka pasur edhe në të kaluarën, rreth 100 vite më parë.

z. Gjergj Nika: Fshatrat kanë qenë më mirë të administruara kur kanë qenë komuna. Edhe qyteti i Vlorës sot ka më pak institucione, pasi shumë prej tyre janë zhvendosur në Tiranë. Orikumi, Novosela dhe Selenica duhet të kenë vetëadministrim dhe të jenë njësi vendore më vete. Bashkimi i tyre do të ishte absurd, duke pasur parasysh gjendjen e vështirë në të cilën ndodhen aktualisht fshatrat. Reforma territoriale ka marrë më shumë karakter politik, ndërkohë që një reformë e tillë duhet të fokusohet te aspekti financiar dhe te ofrimi real i shërbimeve për qytetarët. Buxheti nuk shpërndahet në mënyrë të drejtë sipas nevojave dhe territorit, ndërsa investimet në njësitë administrative janë të pamjaftueshme dhe në shumë raste qesharake.

z. Niko Dumani: Decentralizimi hap rrugën për demokracinë dhe forcon vendimmarrjen pranë qytetarëve. Selenica ka burimet dhe pasuritë e saj natyrore, të cilat duhet të shërbejnë në funksion të zhvillimit të saj. Kjo nuk do të thotë që duhet të bashkohet me Bashkinë Vlorë.

z. Fatmir Abazi: E quaj të vështirë që Bashkia Vlorë të menaxhojë edhe territorin e Bashkisë Selenicë. Bashkia Vlorë është e përqendruar kryesisht në qytetin e Vlorës, ndaj zgjerimi i mëtejshëm i territorit do ta vështirësonte edhe më shumë administrimin dhe ofrimin e shërbimeve. E konsideroj absurde bashkimin e Bashkisë Selenicë me Bashkinë Vlorë. Gjithashtu, mendoj se Orikumi duhet të rikthehet dhe të funksionojë si bashki më vete.

znj. Irena Toshkallari: Ndarja e buxhetit bëhet në bazë të të ardhurave.

z. Barjam Hasani: Jemi të gjithë kundër këtij bashkimi, pasi Bashkia Vlorë nuk mund t'i mbulojë dhe t'i menaxhojë siç duhet të gjitha shërbimet dhe nevojat e komunitetit tonë.

z. Selim Salaj, Matogjin: Nuk jam dakord që të priset Bashkia Selenicë. Përkundrazi, duhet t'i afrohem më shumë popullit dhe të garantojmë që shërbimet të jenë sa më pranë qytetarëve. Gjithashtu, mendoj se Orikumi dhe Novosela duhet të jenë bashki më vete, në mënyrë që të kenë administrim dhe shërbime më pranë komunitetit.

znj. Irena Toshkallari: Të gjitha mendimet dhe qëndrimet e shprehura do t'i përcjellim dhe do t'i marrim në konsideratë në vijim të procesit.

Faleminderit!

Koordinatorë për Njoftim dhe Konsultim Publik

Aurora Kamberaj